



# ANGAZHIMI ME FËMIJËT NË DITËN BOTËRORE KUNDËR TRAFIKIMIT 30 KORRIK

-Ndal trafikimit të Fëmijëve!

- Asnjeherë mos merrni gjëra nga  
persona që nuk i njihni!  
-Shpresë!

Ishin disa prej mesazheve të fëmijëve  
që frekuentojnë Qendrën Komunitare Multidisiplinare  
Tiranë, gjatë një aktiviteti të zhvilluar në kuadër të  
“Ditës Botërore Kundër Trafikimit në Persona”.

Aktiviteti u zhvillua me pjesëmarrjen e fëmijëve të moshave 10-17 vjeç dhe kishte në fokus ndërgjegjësimin e tyre mbi trafikimin e qenieve njerëzore nëpërmjet lojës.

Mjetet për ilustrimin sa më të thjeshtë të fazave në të cilat kalon një viktimë trafikimi përshinë: tollombace në formën e zemrës blu (simbolika e kësaj dite) e cila personifikonte viktimat e rekrutuara të trafikimit, një kamion lodër për të ilustruar fazën se si ndodh transportimi dhe transferimi, një shtëpi prej kartoni për të treguar si ndodh fshehja dhe pritja e personave për shfrytëzim.

Gjatë aktivitetit fëmijëve dhe të rinjve ju mundësuan bojra dhe telajo ku ata u udhëzuan që të krijojnë piktura me mesazhe të personalizuar për të mbijetuarit e trafikimit.



Ndërveprimi me ta tregoi qartë një ndryshim në nivelin e tyre të ndërgjegjësimit dhe vullnetin për të mësuar më shumë mbi trafikimin e qenieve njerëzore si një koncept i përgjithshëm. Në fund fëmijët mësuan mbi mënyrat sesi mund të kërkojnë ndihmë, numrat telefonikë ku mund të raportojnë, dhe personat që duhet të kontaktojnë në rastin e një situatë trafikimi.